


TIK



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR  
DREJTORIA JURIDIKE

28679

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Shkodër, më 31.12.2024

**VENDIM**

Nr. 755 datë 31/12/2024

**“PËR DELEGIM KOMPETENCE”**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligjit nr.44/2015 “Kodi Procedurave Administrative Republikës së Shqipërisë”; ligjit nr.9936 ,datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; ligjit Nr.10 296, datë 08.07.2010 ”Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”; ligjit nr.89 datë.22.12.2022 “Për Policinë Bashkiake”; ligjit nr.114/2015 “Për auditin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar; Udhezimi nr.30/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njesite e sektorit publik” të ndryshuar;

**VENDOSA:**

1. Delegimin e kompetencave të Kryetarit të bashkisë Shkodër, z.Onid Bejleri me detyrë zëvendeskryetar bashkisë Shkodër;
  - për firmosje si nëpunës autorizues.
  - për firmosje si titullar i autoritetit kontraktor për të gjitha procedurat e prokurimit publik.

për të gjithë administratën bashkisë Shkodër.

  - për firmosje shkresore që ka të bëjë me institucionet publike, personat juridik/ fizik dhe individ, për të gjitha drejtorite duke perjashtuar strukturat e deleguar sipas vendimit nr.753,datë 31.12.2024, nr.754,datë 31.12.2024.
2. Zv/Kryetari nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca zyrtarëve të tjerë.
3. Kompetencat e deleguara do të ushtrohen duke filluar nga data 06.01.2025 dhe përfundojnë me datë 30.06.2025, ora 16.00.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet z.Onid Bejleri dhe administrata bashkisë Shkodër.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen WEB të bashkisë Shkodër.

**KRYETAR**

**Benet BECI**

